

## ASPECTS OF THE AGRICULTURAL SITUATION IN THE PREFECTURE OF ELBASAN IN THE '30 OF THE XX CENTURY ASPEKTE NGA SITUATA E PRODHIMIT BUJQËSOR NË PREFEKTURËN E ELBASANIT NË VITET '30 TË SHEK. XX

FLORINKA GJEVORI  
Universiteti "Aleksandër Xhuvani"  
Elbasan, SHQIPËRI  
e-mail florinkagjevori@yahoo.com

AKTET VI, 4: 416-422, 2013

### PERMBLEDHJE

Ky artikull përbën një paraqitje analitike të gjendjes së degëve të ekonomisë bujqësore në vitet 20-30 të shekullit XX, në rajonin e Elbasanit. Mbi bazën e të dhënave arkivore, si dhe të analizës së studiuesve të ndryshëm, artikulli jep të dhëna për peshën specifike që zinte prodhimtaria në fu-shën e bujqësisë së këtij rajoni, në prodhimin e përgjithshëm kom--bëtar. Bujqësia ishte burimi kry--e--sor i të ardhurave dhe i jetesës së popullsisë së kësaj treve, paçka se përgjithsisht ajo paraqitej në gje--ndje jo të kënaqshme. Po kështu analizohen edhe disa prej shkaqeve kryesore të një gjendjeje të tillë dhe përpjekjet konkrete të ndërmarra nga qeveria aktuale, apo edhe nisma individuale nga ra--dhët e shoqërisë, për kapërcimin e kësaj gjendjeje ekonomike. Kriza ekonomike botërore e viteve '30, që përfshiu edhe Shqipërinë, la gjurmë konkrete edhe në ekonominë e prefekturës së El--ba--sa--nit. Kjo analizë, synon të japë një kontribut të rëndësishëm për historiografinë e Elbasanit.

**Fjalet kyce:** produkte bujqësore, prodhim i përgjithshëm kombëtar

### SUMMARY

This article is an analytical presentation of the state of agricultural economy branches on years 20-30 of XX century, in the region of Elbasan. On the basis of archival data, and ana-ly-sis of various scholars, the article provides data on the specific weight that occupied the field of agriculture production of this region, the total national production. Agriculture was the main source of income and livelihood of the area's population, even though it is generally pre-se-nted in unsatisfactory condition. So are analyzed some of the main causes of such a si-tu-a-tion and concrete efforts undertaken by the current government or individual initiatives from di-fferent society groups, to overcome this economic situation. World economic crisis in year 30s, which includes Albania, left concrete traces at the economy of the prefecture of Elbasan. This analysis, I think gives an important contribution to the historiography of Elbasan

**Key words:** agricultural products, total national production

---

### Hyrje

Në vitet '20 të shek.XX, Elbasani paraqitet si një qendër e rëndësishme urbane në Shqipërinë qëndrore. Elbasani gjendej në kryqëzimin e rrugëve tregtare mes prefekturave të Beratit, Vlorës, Durrësit, Tiranës, Korçës deri edhe Gjirokastrës, Dibrës dhe Shkodrës. Nga pikëpamja

fiziko-gjeografike, rajoni i Elbasanit karakterizohej nga një reliev kodrinoro-malor, kurse fushat janë të pakta. Në aspektin agrar prefektura e Elbasanit sikurse të gjitha prefekturat e tjera, paraqiste një gjendje të rënduar ekonomike – shoqërore dhe për më tepër kriza e viteve 1922-'23 e rëndoi më tej situatën në vend. Shkaqet e një gjendjeje të

tillë agrare ishin të shumta dhe duhen kërkuar në një sërë arsyesh: ekzistenca ende e një ekonomie të prapambetur bujqësore, taksat e rënda mbi popullsinë, të metat e qeverisjes dhe sistemi feudal që ruhej ende me mbeturinat e tij të theksuara, mungesa e investimeve nga jashtë, mungesa e një sistemi unik të peshave dhe matjeve etj.

### **Bujqësia ekonomia kryesore**

Në aspektin e zhvillimit ekonomik në trevën e Elbasanit, ashtu si në të gjithë vendin, në vitet '20-'30-të të shek. XX, rolin kryesor e luante bujqësia. Për shkak të pranisë së luginave e fushave pjellore, klimës shumë të favorshme dhe faktorëve të tjerë, prefektura e Elbasanit dallohej për prodhimet e saj bujqësore dhe përhapje të aktivitetit agrar, kryesisht në zonat fushore të Peqinit dhe të Elbasanit. Situata ekonomike, sidomos bujqësia, gjatë periudhës 1920-1924 paraqitej relativisht e mirë. Në vitin 1927, nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës së prefekturës së Elbasanit 2 954 km<sup>2</sup>, punohej vetëm një pjesë e vogël, prej **64 988** ha (tokë private dhe shtetërore). Një siperfaqje prej 277 240 ha, ishte pyllishte dhe tokë e zhveshur dhe 8 862 ha ishte livadh e kullotë, si dhe shkëmbinj e përrenj, shtretër lumenjsh e zallishte.

### **Misri kultura më e kultivuar**

Toka e punuar mbillej me kultura të ndryshme bujqësore si grurë, misër, elb, tërshër, thekër, oriz, duhan etj. Siç përmendet në burimet arkivore, ndër lëvrimet bujqësore të drithrave, ai që ka rëndësinë më të madhe aktualisht është misri, meqenëse ai formon ushqimin kryesor të bujkut dhe deri diku edhe të qytetarëve. Misri mbillej kudo qoftë, prandaj sipërfaqja e kësaj bime është shumë më e madhe se e grurit. Misri në këtë qark gjen kushte të përshtatshme si klima, toka ndaj edhe jep prodhime të mira, megjithëse nuk punohet me vegla të reja.

### **Marrja e masave për shtimin e kultivimit të orizit**

Orizi përbënte një kulturë speciale dhe shumë të rëndësishme për Elbasanin. Zonat e orizokulturës

ndodheshin në buzë të Shkumbinit, kryesisht në katundet Shushicë, Jagodinë, Muriqan, Bradashesh dhe në disa katunde të nënprefekturës së Gramshit, në buzë të lumit Devoll: Sulovë, Gjyralë etj.

Prodhimtaria e tij në vitet '30-të kish ardhur duke rënë ndjeshëm, deri në 1/3 e prodhimit të mëparshëm - analizon një nga relacionet që Ministria e Bujqësisë i dërgonte Zyrës së Bujqësisë në Elbasan. Kjo ishte rrjedhojë e disa faktorëve, si rënia e çmimit të orizit nga konkurrimi i prodhimit të huaj, por edhe e politikës që ndiqnin dhjetarët apo çifligarët e mëdhenj si Demir pasha e trashëgimtarët e tij, duke nxjerrë pengesa në përdorimin e remës së ujit që kalonte nëpër këto toka, për të paguar shumat që ata dëshironin, shuma këto, që shpesh shkonin deri në 1/3 e prodhimit.

Ministria e Bujqësisë, duke theksuar rëndësinë që ka në jetën ekonomike të vendit prodhimi i orizit, sasia e të cilit, e prodhuar në vit për këtë zonë, mjaftonte jo vetëm për të mbuluar nevojat për konsum, por edhe për eksport, i bënte thirrje Zyrës së Bujqësisë në Elbasan për të bërë studime konkrete me anë të inxhinierëve hidraulike, si edhe marrjen e masave për rihapjen e kanaleve të vjetër, ndalimin e pagimit të ujit ndaj qehallarëve, pasi në këtë rast rritet apo zmadhohet mbjellja e kulturës së orizit.

### **Rritja e krimit të mëndafshit**

Rritja e krimit të mëndafshit, ishte një nga degët e bujqësisë që sillte mjaft fitim, jo vetëm në Elbasan, por edhe në pjesën tjetër të vendit. Ky prodhim ka peshë të vogël dhe vlerë të madhe e në këtë pikpamje, nuk mund të krahasohet me prodhimet e tjera të bujqësisë, që kanë peshë të madhe dhe vlerë të vogël (si bar, drith etj).

*Ky rajon me klime të butë, tokë të mirë e kushte të tjera që favorizojnë rritjen e krimit të mëndafshit, krijonte shpresa te banorët e kësaj zone, se shumë shpejt kishin për të pasur një industri agrikole dhe një fitim të madh, - shkruan një nga gazetatat lokale të Elbasanit. Por, për fat të keq, për zhvillimin e kësaj dege, përveç disa masave paraprake, si shpërndarja e fidanëve për të krijuar mandishta, të ndërmarra që në kohë të*

regjimit osman, edhe në fillim të viteve '20 të shekullit XX, nuk ishte bërë ende asgjë konkrete. Shpresat ishin tek Parlamenti Kombëtar dhe deputetët e Elbasanit, të cilët do të kundërshtonin të mos pranohet ndonjë buxhet tjetër veç atij që ka për bazë përmirësimin e degëve të ndryshme të bujqësisë.

Zeja e ushtrimit të mëndafshit është tepër e çmuar në këtë prefekturë, mbasi të gjitha vajzat e vendit, sikurse thotë një dokument i kohës, e hartojnë pajën e martesës me duart e veta, e në më të shumtën me endjen e mëndafshit.

Aq me rëndësi ishte ushtrimi i këtij zanati në Elbasan e në trevat rreth tij, sa që gazeta "Shkumbini", botuar në vitin 1921, në numrat e saj hapi një rubrikë të veçantë me këshilla mbi rritjen e mbarështimitin e krimbit të mëndafshit. Në një nga numrat e saj kjo gazetë shkruante se "e shumta e mëndafshit që bahet në këtë qark punohet po në vend, d.m.th. tërhiqet, dridhet, ngjyhet dhe endet pëlhurë. Pëlhurat e mëndafshita të këtij qyteti dërgohen në të gjitha viset e Shqipnis jugore edhe nxirren për Maqedoni e Greqi." Këto këshilla i jepte agronomi Ismail Haxhi Hyseni, i specializuar jashtë vendit.

Lloji i çmuar më tepër në prefekturë, është ai i bardhë në krahasim me mëndafshet me ngjyrë. Ministria e Ekonomisë i dërgonte dhe u shpërndante në muajin prill 4 familjeve të pasura, që kishin ambiente të mjaftueshme e të përshtatshme, punonjës të stërvitur për këto lloj punimesh mëndafshi, si dhe rreth 60 gram farë mëndafshi. Kjo sasi ndahej në mënyrë të barabartë mes këtyre familjeve, nga 15 gr. secilës, konkretisht familjeve të Hysejn Misirit, Qamil Shkodrës, Mehmet Cërragës dhe Hysejn Shabanajt.

### **Të përkrahet kultivimi i duhanit**

Mjaft toka të prefekturës së Elbasanit janë shumë të përshtatshme për kulturën e duhanit. Në vitin 1934, prodhimi i kësaj kulture ra ndjeshëm dhe kjo për arsye të thatësisë së madhe. Megjithëse u përdorën për mbjellje edhe fidanë të llojeve të reja si Basma dhe Pashiballi. Por edhe prodhimi i viteve të tjera nuk ishte shitur në masën e

mjaftueshme, për shkak të superprodhimit, pasi nuk ishin siguruar tregjet.

Në kuadrin e propozimeve dhe masave konkrete që do të merrte Ministria e Bujqësisë, për kapërcimin e kësaj krize në kulturën e duhanit, do të propozoheshin masa konkrete, që në mënyrë të tërthortë të favorizohen vetëm ato qarqe që kishin toka më të përshtatshme e që do të përcaktoheshin si zona duhanore dhe nga ana tjetër, të ndalohej prodhimi në ato qarqe, që nuk përmbushnin kushtet teknike për mbjelljen e kësaj bime. Elbasani do të bënte pjesë në atë kategori të qarqeve, që shihen si më adapte ndër zonat duhanore.

### **Të ndihmohet mbjellja e grurit**

Mbjellja e grurit kufizohet në një sipërfaqje të vogël tokash, në krahasim me mbjelljen e misrit, dhe punimet që kërkonte kjo kulturë kryheshin në mënyrë fare primitive. Një kujdes i posaçëm, me përkrahjen e autoriteteve administrative dhe sidomos të prefektit të Elbasanit, i është kushtuar zhvillimit të kulturës së grurit nga viti 1926 deri në vitin 1929, duke detyruar bujqit e disa komunave si Dumre, Qendër, Shpati II për punimin e tokave për mbjellje gruri që në muajin gusht, për çeljen e kanaleve në arat e e mbjella me këtë kulturë për kullimin e ujit dhe pastrimin e farës.

### **Kultivimi i pemëve frutore**

Në Prefekturën e Elbasanit zonat me rëndësi për nga drujtë frutorë janë: Cermenika I dhe II, katundi Labinot, si dhe Qendër. Gati çdo shtëpi ka të sistemuar në kopshtije një sasi prej 30-40 pemësh të ndryshme, kryesisht për nevoja shtëpiake, por edhe për shitje.

Në kopshtet e qytetit të Elbasanit, përveç pemëve të zakonshme si mollë, dardha, qershi, fiq, shegë, hurma, kultivoheshin edhe agrume, sidomos portokallet e limonët. Në zonat rurale pemët kryesore që kultivoheshin ishin: molla, dardha, qershia, gështenja, arra; mandej, sipas vendit fiku, pjeshkët, bajamet, zerdelia. Përmendim se me përjashtim të qendrës e zonave të ulta, në krahinat e tjera, sidomos përgjatë luginës së Shkumbinit, lartësia nga niveli

i detit bënte që këto vende të rroken fort prej erërave të ftohta. Prandaj prodhimi i larmishëm i frutave ishte i vështirë.

### **Roli i Zyrës së Bujqësisë**

Në Elbasan në vitet '20-'30-të funksiononte Zyra e Bujqësisë. Veprimtaria dhe fusha e aktivitetit e kësaj zyre, por edhe e zyrave të tjera në përgjithësi, deri në vitin 1925 ka qenë e ngushtë dhe e kufizuar thjesht në dhënie këshillash e propagandë, për të ngjallë në shpirtin e bujkut ndjenjën e veprimeve të duhura në zhvillimin dhe përparimin e bujqësisë. Kjo ndodhte për disa arsye, por ndër më kryesoret kanë qenë se nuk ka pasur një organizim komunal, nuk disponoheshin plotësisht as ligjet e duhura nga Ministria e Ekonomisë Kombëtare (MEK).

Pas vitit 1925, me përgatitjen e ligjeve të duhura prej MEK, Zyra e Bujqësisë fillon të orientojë popullin dhe bujkun në veçanti, për të aplikuar rregulla të reja për përmirësimin e bujqësisë. Po kështu MEK, duke sjellë nga jashtë vegla bujqësore, me qëllim punimin cilësor të tokës, shpërndau në rajonin e Elbasanit rreth 600 copë parmenda të hekurta, përdorimi i të cilave do të ndikonte drejtpërdrejt në rendimentet e prodhimtarisë.

### **Pjesëmarrja në prodhimin kombëtar**

Sipas të dhënave të vitit 1933, po të krahasojmë shifrat e disa prodhimeve bujqësore të marra në këtë prefekturë me prodhimin kombëtar të përgjithshëm, rezulton se Elbasani zë këto vende:

**Vendin e gjashtë për prodhimin e grurit**, duke u renditur pas prefekturës së Korçës, Beratit, Gjirokastrës, Shkodrës dhe Durrësit. Ndërkohë që Prodhimi i Përgjithshëm Kombëtar ishte 650 832 kv dhe sipërfaqja e përgjithshme e kultivuar 43 329 ha, Elbasani jepte 8 % të këtij prodhimi.

**Për elbin Elbasani zinte vendin e dytë** pas Korçës, prodhimi i kësaj të fundit ishte 2.5 herë më i madh, kur P.P.K. ishte 89 935 kv dhe sipërfaqja totale 6 100 ha, ndërsa Elbasani jepte 16 % të këtij prodhimi.

**Për misrin Elbasani rradhitej i katërti** pas Beratit, Durrësit, Korçës, kur P.P.K. ishte 1 093 225 kv dhe

sipërfaqja 77 295 ha, ndërsa Elbasani zinte 12 % të këtij prodhimi.

**Për prodhimin e orizit e të tepës zë vendin e parë** dhe totali për secilën prej tyre, përkatësisht paraqitet: (1) për orizin sipërfaqja totale në Shqipëri 1 905 ha dhe P.P.K. 4 090 kv, ndërsa Elbasani jepte 73 % të këtij prodhimi; (2) për tepën sipërfaqja totale ishte 1 819 ha dhe P.P.K. 14 028 kv, ndërsa Elbasani jepte 54 % të këtij prodhimi.

**Elbasani zë vendin e tretë** për prodhimin e tërshërës si dhe të ullishtave.

**Për prodhimin e ullinjve, në vitin 1935, Elbasani zinte vendin e tretë** pas Vlorës dhe Beratit, kurse në vitin 1936 zbriti në vendin e gjashtë.

Kjo situatë e prodhimit bujqësor të këtyre viteve, është e lidhur me faktorët klimaterikë dhe atmosferikë, por edhe me rolin dhe politikën e shtetit ndaj kujdesit për bujqësinë apo fshatësinë.

### **Rënia e prodhimeve bujqësore**

Kriza e viteve 1929-1933, që përfshiu edhe ekonominë e brishtë shqiptare, pati efektet e veta në fushën e bujqësisë, si në krejt vendin, ashtu edhe në trevën e Elbasanit. Treguesi më i dukshëm i kësaj krize ishte rënia dhe luhajtja e madhe e prodhimit bujqësor dhe blektoral. Në vitin 1931 bujqësia u prek nga një thatësi e madhe. Si pasojë e kësaj thatësie, nga njëra anë, dhe e krizës ekonomike nga ana tjetër, prodhimi bujqësor pati një rënie të theksuar, gjë që ndikoi edhe në vitin pasardhës. Vendi u detyrua të importonte sasira të mëdha drithi.

Rënie të theksuar e luhajtje të mëdha pati në prodhimet bujqësore, sidomos në prodhimin e duhanit, i cili ishte ndër mallrat kryesorë të eksportit shqiptar. Në vitin 1931 u prodhuan 54 për qind më pak ton duhan se sa në vitin 1930. Për rënie e prodhimtarisë së orizit revista "Ekonomisti Shqiptar", në vitin 1932, në një nga numrat e saj, shkruante "orizin tonë po e zhduk krejt konkurrenca e huaj".

Në një raport për gjendjen ekonomike të Qarkut të Elbasanit dërguar Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare, Oda e Ekonomisë së këtij qarku, vinte në dukje ndër të tjera se, importi i orizit të kuq

me çmim shumë më të vogël e luftonte prodhimin e vendit. Duke qenë se gjysma e sasisë së orizit kishte mbetur pa u shitur, fabrikantët u rezervuan të blenin oriz të papunuar.

Konkurenca e orizit të importuar, që shitej me çmime shumë më të ulëta se orizi i vendit, krijoi një gjendje mjaft kritike në këto punishte. Për të kuptuar se sa e madhe ishte diferenca e çmimit ndërmjet orizit të importuar dhe orizit të vendit, na ndihmojnë disa të dhëna të tregut të Elbasanit në muajin Prill të vitit 1931, ku rezultonte se çmimi i orizit të importuar i llojit "Berliata" ishte 40 franga ari për kv; çmimi i orizit të llojit "Saigon" ishte 45 franga ari për kv; ndërsa çmimi i orizit të vendit i llojit "i Kuq" ishte 56 franga ari për kv. Kjo gjendje goditi drejtpërsëdrejti jo vetëm atë pak industri shqiptare që merrej me zhvishjen e orizit, por në mënyrë të veçantë ekonomitë bujqësore prodhuese të orizit.

Po kështu, në një raport bujqësor të prefekturës së Elbasanit për muajin mars të vitit 1934, thuhet se për shkak të shirave të tepruar në muajin mars, punimet e tokave për përgatitjen e mbjelljes së misrave të dorës së parë, që fillon zakonisht në muajin prill, janë penguar, kurse për gjendjen e të lashtave kjo situatë e shirave është favorizuese. Në një raport tjetër të po këtij viti thuhet se, në muajin prill, gjendja e të lashtave është përkeqësuar për shkak të mungesës së shirave në këtë muaj.

Në vitin 1934, duke u bazuar në të dhënat e regjistrimit të zyrës së të dhjetave për qarkun e Elbasanit, sipërfaqja e mbjellë me grurë, rezulton të jetë 70 % më pak se sa një vit më parë, pikërisht për shkak të motit të keq të vazhdueshëm gjatë kohës së mbjelljes së kësaj kulture. Veprimet bujqësore të shqyrtuara nga analiza e Zyrës së Bujqësisë, tregojnë qartë se kjo rënie përgjithësisht është e varur nga fatkeqësitë atmosferike si thatësira, lagështia, i ftohti etj. Të dhëna të tjera flasin për keqësim të situatës së prodhimit të disa pemëve frutore, për shkak të ftohjes së motit në vitin 1935. Në mënyrë të veçantë agrumet e ullinjët, në këtë vit nuk dhanë prodhim të kënaqshëm, edhe si pasojë e përhapjes së insektit iceria-purchasi dhe nga ana

tjetër, si rrjedhojë e shirave të vazhdueshëm të muajit dhjetor, 1/5 e prodhimit ka humbur.

### **Masat për përmirësimin e gjendjes**

Me qëllim që t'i jepet rëndësia e duhur kulturës së ullirit, apo dhe kulturave të tjera të kësaj zone, veprimtaria e Zyrës së Bujqësisë do të konsistojë në një sërë masash si: dërgim i specialistëve për krasitjen e ullinjve apo demonstrim krasitjeje për rreth 3 000 rrënjë ullinj e një sërë pemësh të tjera. Kjo zyrë i kushtoi vëmendje aplikimit të ligjit mbi mbjelljen e detyrueshme të drurëve frutorë e jofrutorë pranë oborreve të shtëpive, si p.sh. mbjellja e rreth 700 rrënjëve ullinj të nxjerra nga ullishta e qytetit, sjellja dhe mbjellja e farës së duhanit maqedonas për përmirësimin e cilësisë së farës vendase, shpërndarja po kështu e hardhive amerikane apo i pemëve të tjera frutore, i bimëve industriale si lini, pambuku etj. Në vitet 1929-1931 për shkak të korrjeve të varfra, çmimet e drithrave të bukës në përgjithësi nuk patën rënie të madhe, ndërsa në vitet 1932-33, çmimet e këtyre prodhimeve bujqësore tepër të rëndësishme u ulën ndjeshëm. Kështu, çmimi i shitjes së grurit, nga 34 deri në 54 franga ari për kv që ishte në tregjet kryesore të vendit në korrik të vitit 1931, në korrik të vitit 1932 ra në 19.97 fr. ari, ndërkaq në korrik të vitit 1933 ra akoma më poshtë, në 9.5 fr. për kv.

Në korrik të vitit 1934 u arrit vlera më e ulët e çmimit të shitjes së drithërave, konkretisht për grurin kemi çmimin 7.55 fr. ari për kv. Në rënie e fortë të çmimeve të produkteve bujqësore dhe blektorale, ndikoi edhe politika monetare dhe e kreditit e Bankës Kombë

tare, duke thelluar deflacionin, nëpërmjet pakësimit të parasë në qarkullim, rritjes së kërkesës së tregut për monedhë dhe në të njëjtën kohë, kufizimit të kreditimit të veprimtarisë prodhuese ekonomike. Me këto masa BK rriti artificialisht vlerën e frangut, që u shoqërua me uljen e çmimeve në treg. Nga ana tjetër, kjo politikë e mbrapshtë monetare, e ndjekur nga BK, i shërbeu kapitalit monopolist italian për grabitjen e tregut shqiptar, nëpërmjet blerjes së produkteve shqiptare, në rastin tonë të prodhimeve bujqësore e blektorale me çmime të ulëta.

Ndërkohë, popullata e thjeshtë nuk ka mundësi blerje për arsye të varfërisë dhe mungesës së parave në qarkullim.

Zikzaket e prodhimit bujqësor shihen qartë edhe në tabelë për vitet 1933-1936, e cila paraqet disa

prej produkteve kryesore që kultivoheshin në prefekturën e Elbasanit, prodhimin vjetor të tyre si dhe sipërfaqet e kultivuara.

Kulturat	v. 1936		v. 1935		v. 1934		v. 1933	
	SIP. NE HA	Prodh. ne kv	SIP. NE HA	Prodh. ne kv	Sip. ne ha	Prodh. ne kv	SIP. NE HA	Prodh. ne kv
Grure	2340	16815	2110	20535	3154	30122	3823	48526
Elb	681	4730	683	6258	884	8625	1104	13944
Miser	9436	128070	8627	102991	9357	132925	12786	135443
Tershere	1031	8420...	933	8856	1299	13468	1488	22472
Oriz	1415	3000	1144	2560	---	--	--	--
Tepe	11039ne dynam	7650	10248	8858	--	--	==	--
Theker	1534ne dynam	1154	903	713	--	--	==	--
Patate	--	--	--	--	----	==	--	--
Urof	--	---	--	---	--	==	--	--
Groshe	---	1820	---	2232	--	==	==	==
Bostan	103	640	159	702	--	==	--	--
Vreshta e pjergulla	616	3110	657	23929	==	--	--	--
Ullishte	489123. rrenje me fruta	4430	482464	21823	--	--	--	--

**Tabele nr. 1** Pasqyrë për disa kultura bujqësore në qarkun e Elbasanit në vitet 1933-1936, që evidenton rënien e ndjeshme të sipërfaqeve të kultivuara dhe prodhimtarisë.

### Përfundime

Bujqësia ishte burimi kryesor i të ardhurave dhe i jetesës së popullsisë së kësaj treve, për periudhën në fjalë, paçka se përgjithsisht ajo paraqitej në gjendje jo të kënaqshme, rrjedhojë kjo e veprimit të një sërë faktorëve. Arsyet kryesore të prapambetjes në bujqësi ishin: pronësia dhe marrëdhëniet feudale mbi një pjesë të mirë të sipërfaqes së tokës, si dhe prapambetja e theksuar e punimit dhe e trajtimit të tokës në përgjithësi. Lidhur me këtë të fundit shprehet edhe shtypi i kohës, në vitin 1921: „Bujku

*shqiptar gjindet aty ku ish njerzia para ma se dy mijë vjet, me vegla krejt primitive në dorë“.* Në krizën e bujqësisë së viteve 1931-1935 ndikuan një sërë faktorësh, si të brendshëm, ashtu edhe të jashtëm. Ndër më kryesorët mund të rendisim: prapambetjen në tërësi të ekonomisë shqiptare; ngushtimin e tregut të brendshëm për shkak të rënies së fuqisë blerëse të masave punonjëse; konkurrencën e produkteve bujqësore e blektorale, të cilat sillleshin nga jashtë; praninë e mbeturinave feudale në prodhim; detyrimet e rënda të fshatarësisë ndaj shtetit etj. Këta

faktorë, të marrë së bashku, e bënin të painteresuar fshatarin për zhvillimin e bujqësisë dhe për shtimin e prodhimit nëpërmjet rritjes së rendimenteve të kulturave bujqësore e blektorale.

#### **Bibliografia**

AQSH, F. 171, v. 1934, D. IV-272, D IV-290.

AQSH, F. 271, v. 1929, D. IV-10.

AQSH, F. 271, v. 1932, D. IV-181.

AQSH, Fond 271, viti 1935, dosje IV-339, dosje IV-336.

AQSH, F. 271, v. 1934, D. IV-290.

AQSH, F. 271, v. 1936, D. 152.

GAZETA "Shkumbini", nr. 23, v. 1921.

GAZETA "Shkumini", nr. 14, 15 prill 1921.

GAZETA "Shkumini", nr. 20, 27 maj 1921.

GAZETA "Shkumini", nr. 21, 3 qershor 1921.

FISHTA, I. & TOCI, V., Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj , shkaqet dhe pasojat, Tiranë 1983.

SELENICA, T., Shqipëria ne vitin 1927, Tirane 1928..